STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 19 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE HETIMI I DFS-SE IDENTIFIKON BANKAT ME STATISTIKAT ME TE KEQIJA TE NDIHMES PER SENDIN (SANDY)

Mesatarisht, 'dhjetë bankat e fundit' janë duke mbajtur pothuajse gjysmën e fondeve të sigurimeve për Sendin (Sandy) që kanë marë, shumë më tepër sesa mesatarja e gjithë industrisë prej 17 përqind

'Dhjetë bankat e fundit' janë duke mbajtur miliona të ndihmës së sigurimeve për Sendin (Sandy) për pronarët e shtëpive të prekur

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) (DFS) ka identifikuar 'dhjetë bankat e fundit' me statistikat më të këqija në lidhje me pagesën e kërkesave të sigurimeve për viktimat e super stuhisë Sendi (Sandy) dhe i ka njoftuar ato të përshpejtojnë dhënien e atyre fondeve për pronarët e shtëpive të prekur.

"Shteti ka punuar mjaft për të pakësuar burokracinë për pronarët e shtëpive të prekur nga super stuhia Sendi (Sandy) në mënyrë që të mund të marrin ndihmën që u nevojitet për të rindërtuar dhe për t'u rimëkëmbur sa më shpejt që të jetë e mundur," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ndërsa nuk do të jemi të kënaqur derisa çdo viktimë e vetme të marë çdo dollar që u takon, disa banka kanë vazhduar të mbeten pas veçanërisht shumë pas të tjerave dhe ka ardhura koha që të përshpejtojnë ritmin."

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare (Superintendent of Financial Services), tha, "Bankat me rendimentin më të ulët janë duke mbetur shumë pas drejtueseve dhe janë duke mbajtur miliona në ndihmën kaq të nevojshme për Sendin (Sandy). Pronarët e shtëpive meritojnë trajtim mjaft më të mirë nga bankat e tyre dhe do të vazhdojmë të luftojmë për t'u siguruar se këto fonde jepen për të përshpejtuar rimëkëmbjen."

Një hetim nga Departamenti i Shërbimeve Financiare të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of Financial Services) (DFS) – që analizoi 33 nga bankat dhe agjencitë e hipotekave më të mëdha të kombit – zbuloi se:

- Mesatarisht, 'dhjetë bankat e fundit' janë duke mbajtur pothuajse gjysmën (44 përqind) të kërkesave të sigurimeve për Sendin (Sandy) që kanë marë – shumë më tepër sesa mesatarja e gjithë industrisë prej 17 përqind.

- Ato ‘dhjetë banka të fundit’ janë duke mbajtur tashmë 1,109 çeqe për kërkesat e sigurimeve për Sendin (Sandy) gjithsej pothuajse 41 milionë dollarë.
- Një prej ‘dhjetë të fundit,’ Selene Finance, ende është duke mbajtur pothuajse tre të katërtat (71 përqind) të fondeve të sigurimeve për Sendin (Sandy) që ka marë. Asnjë banka nga dhjetë të fundit nuk është duke mbajtur më pak se 38 përqind të fondeve të sigurimeve për Sendin (Sandy) që ka marë.

Analiza e DFS-së tregoi se tre prej bankave më të mëdha të kombit – CitiMortgage, JPMorgan Chase dhe Bank of America – janë duke mbajtur tashmë një mesatare prej vetëm 11 përqind të të ardhurave të sigurimeve që kanë marë. Me fjalë të tjera, ato tre banka kanë dhënë më shumë se 89 cent për çdo dollar që kanë marë. Gjashtë banka dhe agjenci kanë dhënë tani më shumë se 90 cent për çdo dollarë që morën. Gjithsej, bankat që analizoi DFS kanë paguar më shumë se 1.1 miliardë dollarë në kërkesa të sigurimeve për Sendin (Sandy) për pronarët e shtëpive.

Shumë viktima të super stuhisë Sendi (Sandy) që marrin çeqe të kërkesave të sigurimeve janë duke u përballur me një pengesë që shpesh nuk e kishin parashikuar: çeku është lëshuar së bashku për pronarin e shtëpisë dhe atë bankë ose agjenci të hipotekës të pronarit të shtëpisë, duke kërkuar kështu miratimin nga banka të çekut përpara sesa pronari i shtëpisë të mund të përdorë fondet. Ky miratim i dyfishtë është një kërkesë standarte e dokumentave të hipotekës dhe kontratave të sigurimit.

Në dhjetor 2012, Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) dhe bankat kryesore arritën një marrëveshje që e përmirësoi gjendjen duke përshpejtuar çeqet paraprake për pronarët e shtëpive. Departamenti gjithashtu u dërgoi letra bankave dhe agjencive të hipotekave në shkurt 2013 duke propozuar një grup praktikash më të mira për të ndihmuar që t’u japin ndihmën pronarëve të shtëpive më shpejt.

Që nga letra e fundit e Departamentit për institucionet financiare mbi këtë çështje në shkurt, bankat dhe agjencitë e hipotekave kanë thënë se do të japin menjëherë 112 milionë dollarë shtesë për viktimat e stuhisë, përveç dhënieve të rregullta të tyre. Për më tepër, përfaqësues nga pesë banka dhe agjenci të shërbimeve—JP Morgan Chase, Wells Fargo, CitiMortgage, Bank of America dhe Ocwen—kaluan javën e parë të marsit në Qendrat e Ndihmës për Katastrofën (Disaster Assistance Centers) të DFS-së anembanë rajonit dhe së bashku ndihmuan më shumë se 600 banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) në dhënien e të ardhurave të tyre nga sigurimet.

Kryeinspektori Loski (Lawsky) tha, “Me kërkesë të DFS-së, shumica e bankave kryesore ndëmori masa të pashembullta në këto rrethana të pashembullta për t’u dhënë para klientëve të tyre për t’i ndihmuar që të rimëkëmben. I vlerësojmë ato përpjekje dhe këmbëngulim që konkurrentët e tyre të ndjekin shembullin e tyre.”

Një listë e ‘dhjetë bankave të fundit’ dhe sasia e fondeve të sigurimeve për viktimat e Sendit (Sandy) që ato po mbajnë është përfshirë më poshtë:

	Sasia gjithsej e të ardhurave nga sigurimet që ende po mbahet	Përqindja e të ardhurave nga sigurimet që ende po mbahet
Selene Finance	1,872,333 dollarë	71%
Select Portfolio	4,859,158 dollarë	56%
Astoria Federal	3,668,003 dollarë	48%
Capital One	3,700,158 dollarë	45%
Nationstar Mortgage	6,032,216 dollarë	44%
Flagstar	2,922,580 dollarë	43%
Specialized Loan	1,373,576 dollarë	41%
OneWest Bank	14,332,160 dollarë	39%
Sun Trust Mortgage	$712,884 dollarë	39%
Mid-Island Mortgage	$1,251,184 dollarë	38%
Gjithsej dollarë/Mesatarja %	**40,724,252 dollarë**	44%

Sot, Kryeinspektori Loski (Lawsky) u bëri thirrje përsëri bankave dhe agjencive të hipotekave që të zbatojnë praktikat më të mira që DFS paraqiti në letrën e saj në shkurt 2012 letter. Ato praktika më të mira përfshijnë:

1. Botimin e informacion të qartë, lehtësisht të disponueshëm në faqet e tyre në internet, duke përshkruar procedurat që kërkohen për të dhënë fonde, të sigurojnë kopje të formularëve të kërkuar dhe të rendisin informacionin e kontaktit për përfaqësuesit e konsumatorëve.

2. Caktimin e një pikë të vetme kontakti për pronarët e shtëpive.

3. Dhënien menjëherë të gjitha fondet e caktuara nga ndërmarrja e sigurimit si fonde "urgjente" ose "paraprake".

4. Lejimin e paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nëpërmjet faksit dhe e-mailit. Fakset dhe e-mailat që kanë lidhje me stuhinë Sendi (Sandy) duhet të kenë një numër të veçantë, të caktuar faksi dhe adresë e-maili për të përshpejtuar përpunimin.

5. Minimizimin e sasisë së dokumentacionit të kërkuar gjatë secilës fazë të riparimit.

6. Mbajtjen e të gjitha të ardhurat nga sigurimi në një llogari escrow që jep interes në përfitim të pronarit të shtëpisë.

7. Përpunimin e të gjithë postës në ditën e marrjes.

8. Pas marrjes së dokumentacionit të plotë, dhënien e të ardhurave ditën e marrjes.

9. Në rastin kur marrin dokumentacion jo të plotë, njoftimin e pronarit të shtëpisë menjëherë me udhëzime të hollësishme mbi kërkesat shtesë.

10. Për ato me degë, pranimin e dokumentave dhe miratimin e çeqeve në të gjitha vendndodhjet e degëve.

11. Kur të ardhurat nuk mund të jepen personalisht në një vendndodhje të degës, dhënien e fondeve përmes transferës elektronike ose dërgesës gjatë natës.

12. Kërkimin e kontrollit vetëm kur kërkohet posatçërisht nga udhëzimet e investitorit.

13. Atje ku kërkohet kontroll, dërgimin e inspektorëve brenda dy ditësh nga marrja e dijenisë për kërkesën e pronarit të shtëpisë për një inspektim të tillë.

14. Kryerjen e të gjitha kontrolleve me shpenzimet e vetë agjencisë.

15. Pas marrjes së provës se pronari i shtëpisë është duke kërkuar vetëm rimbursim për para të shpenzuara tashmë në riparime të shtëpisë, dhënien e çekut ose transfertës elektronike drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht për pronarin e shtëpisë.

16. Patjen e personelit të mjaftueshëm për të vepruar në përputhje me të gjitha praktikat e mësipërme.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418